



NJOFTIM PËR MEDIA

Ditën e enjte, në datën 8 tetor 2020, në mjediset e AMA-s, u zhvillua mbledhja e radhës e Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), ku morën pjesë anëtarët e mëposhtëm:

Gentian	SALA	Kryetar
Sami	NEZAJ	Zëvendëskryetar
Agron	GJEKMARKAJ	Anëtar
Gledis	GJIPALI	Anëtar
Suela	MUSTA	Anëtar

AMA, pasi shqyrtoi çështjet e rendit të ditës, vendosi:

1. “Të përcaktojë si afat për kalimin në transmetimet numerike, në qarqet Kukës, Dibër dhe Gjirokastrë, datën 30 dhjetor 2020”. **(Vendimi nr. 82, datë 08.10.2020)**
2. “Miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në vendimin e AMA-s, nr. 183, datë 19.12.2019, “Për miratimin e projektbuxhetit për vitin 2020”, të ndryshuar” **(Vendimi nr. 83, datë 08.10.2020)**
3. “Mosmiratimin e projektregullores “Për procedurat dhe kriteret për dhënien e autorizimit për përdorimin e frekuencave të brezit HF, për ofrimin e shërbimit audio”. **(Vendimi nr. 84, datë 08.10.2020)**
4. “Mosmiratimin e projektvendimit “Për disa shtesa në vendimin e AMA-s, nr. 220, datë 01.12.2017 “Për miratimin e pagesave për licencë/autorizim dhe shërbimet që kryhen nga Autoriteti i Mediave Audiovizive”. **(Vendimi nr. 85, datë 08.10.2020)**
5. “Përcaktimin e frekuencave për shërbimin e transmetimit audio analoge dhe çeljen e garës për dhënien e licencave të transmetimit audio analoge”. **(Vendimi nr. 86, datë 08.10.2020)**
6. “Çeljen e procedurës për lëshimin e 2 licencave lokale të shërbimit të programit audioviziv të përgjithshëm në qarqet Tiranë dhe Durrës”. **(Vendimi nr. 87, datë 08.10.2020)**
7. “Rinovimin e licencës së shoqërisë “Good News J-Media” sh.p.k., për subjektin audio privat “Radio 7 Nord” dhe saktësimin e zonës së ofrimit të shërbimit të subjektit nga “*Bashkitë Shkodër dhe Vau i Dejës*” në “*Bashkitë Shkodër, Vau i Dejës dhe Njësinë administrative Koplík*”. **(Vendimi nr. 88, datë 08.10.2020)**
8. “Kalimin e të drejtave që burojnë nga licenca e subjektit person fizik Orjana Cenko, për shërbim audioviziv analog “Tv Channel 7” tek shoqëria “Channel 7” sh.p.k.” **(Vendimi nr. 89, datë 08.10.2020)**
9. “Dhënien e autorizimit, shoqërisë “Selenice Kabllor” sh.p.k., për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor “Selenicë Kabllor”. **(Vendimi nr. 90, datë 08.10.2020)**

10. “Rinovimin e autorizimit të shoqërisë “Tata Junior” sh.p.k., për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor “Tv Kabllor Tata Junior”. **(Vendimi nr. 91, datë 08.10.2020)**
11. “Rrëzimin e aplikimit të subjektit person fizik Rahman Mekollari, autorizuar për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor “Tv Kabllor Kristal”, për zgjerimin e zonës së ofrimit të shërbimit në njësinë administrative Librazhd”. **(Vendimi nr. 92 datë 08.10.2020)**
12. “Pranimin e kërkesës së shoqërisë “Dynamicssound” sh.p.k., licencuar për subjektin audio “Radio One”, për ndryshimin e kushteve teknike të licencës”. **(Vendimi nr. 93 datë 08.10.2020)**

AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

Tiranë, më 08 tetor 2020